

## **NJOFTIM**

### **SHËRBIMI INFORMATIV I SHTETIT NJOFTON PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË ANKANDIT PUBLIK PËR SHITJE AUTOMJETESH(KAMIONA)**

Në mbështetje të ligjit nr.9874, datë 14.02.2008 “Për Ankandin Publik” i ndryshuar, si dhe vendimit nr.1719, datë 17.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të ankandit publik” i ndryshuar, njoftojmë sa më poshtë:

- Fillimin e procedurës së hapur të ankandit për shitje automjetesh (kamiona), të vlerësuar si të panevojshëm për institucionin për një periudhë afatgjate, me të dhënat e mëposhtme:

- Benz UNIMOG Kamion, nr. i shasisë: 43511510093392, viti i prodhimit: 1976.
- Liaz (Saurrel) MT-6 Kamion, nr. i shasisë: TNI150261L2DA0084, Viti i prodhimit: 1986.
- MAN Kamion, nr. i shasisë: 02519261926, viti i prodhimit: 1975.

- Vlera e përgjithshme fillestare e ankandit 1 800 000 (një milion tetëqind mijë) lekë, i ndarë përkatësisht në lote:

Loti I: 600 000 lekë.

Loti II: 600 000 lekë.

Loti III: 600 000 lekë.

- Seti i dokumentave të ankandit do të jetë në dispozicion për çdo ofertues, në faqen zyrtare të internetit të Shërbimit Informativ të Shtetit, ndërsa mund të tërhiqet pranë SHISH çdo ditë nga ora 8:00 deri në 11:00, brenda afatit të fundit të pranimit të ofertave.

- Njoftimi do të qëndrojë i publikuar për një periudhë 22 ditore kohë gjatë së cilës çdo i interesuar mund të paraqesë me shkrim ofertën.

- Ofertat do të dorëzohen vetëm dorazi ose me postë pranë Shërbimit Informativ të Shtetit me adresë Rruga: Kongresi i Manastirit, Tiranë dhe afati i fundit i pranimit do të jetë data 07.12.2015, ora 10:00.

- Hapja e ofertave do të bëhet më datë 07.12.2015, ora 10:00.

- Ofertat e paraqitura pas afatit të fundit të pranimit të sipërcituar, do t'u kthehen të pahapura ofertuesve që i kanë paraqitur ato.